



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:256437
Datë: 19.11.2024
Numri i dokumentit: 06471535

Rev.nr.504/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami , kryetar Nenad Llaziq dhe Mr.sc. Muhamet Rexha, anëtar, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit R. K. nga P., Lagjja, Rruga “”, Nr..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Jeton Osmani, avokat nga P., Rruga “...”, Nr..., kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P., Rruga “....”, të cilën e përfaqëson F. S., sipas autorizimit, për kthim në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale, vlera e kontestit 28,495.00 euro, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1413/2021, të datës 25.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.11.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i paditësit R. K. nga P. dhe revizioni i të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1413/2021, të datës 25.07.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1914/2016, të datës 26.02.2020, ishte vendosur "I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit R. K. nga P., Rruga “...”, Nr..., ashtu që anulohen vendimet e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P., Vendimi me Nr. ... i datës 15.06.2016, Vendimi me Nr. i datës 25.07.2016 dhe Vendimi me Nr... i datës 24.08.2016, si të kundërligjshme. II. Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P. që paditësin R. K., ta kthej në vendin e tij të punës, në pozitën e Drejtorit të Departamentit

Juridik dhe Administratës, apo në ndonjë vend tjetër të punës i cili i përgjigjet pozitës tjetër ekuivalente me pozitën që e ka mbajtur paditësi deri me datë 15.06.2016, në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. III. Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P., që paditësit R. K., në emër të kompensimit të diferencës së pagës neto dhe bonuseve tjera përcjellëse të perealizuara, duke filluar nga data 01.08.2016 e deri me datë 31.12.2019, (dita kur është nxjerr ekspertiza financiare), ti paguaj shumën prej 24,363.23 euro (njëzet e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tri euro e njëzet e tre cent), me kamat ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 26.02.2020, dita kur është marr aktgjykimi e deri në pagesën definitive, kontributin pensional dhe tatimin në burim, duke filluar nga data 01.08.2016, e deri sa paditësi të kthehet në pozitën e tij të punës, të gjitha këto në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. IV. Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P., që paditësit R. K., ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 1,169.20 euro (njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent), në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. V. Detyrimet e pagesës së Kontributit Pensional, në shumën prej 1,424.75 euro (njëmijë e njëqind e njëzet e katër euro e shtatëdhjetë e pesë cent) dhe Tatimit në Burim, në shumën prej 2,707.03 euro, (dy mijë e shtatëqind e shtatë euro e tre cent), janë detyrime që e paditura i ka Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe Trustit Pensional të Republikës së Kosovës, dhe mos pagesa e tyre parqet shkelje serioze ligjore.

Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, Ac.nr.1413/2021, të datës 25.07.2024, ishte vendosur "I. Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësit R. K. nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1914/16, i datës 26.02.2020 sa i përket pretendimet të paditësit, vërtetohet. II. Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P., Rruga "...", ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1914/16, i datës 26.02.2020 në pikën e I-rë të dispozitivit, vërtetohet. III. Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P., Rruga "...", ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1914/16, i datës 26.02.2020 në pikën IV-të të dispozitivit, vërtetohet. IV. Refuzohet ankesa e paditësit R. K. nga P. dhe PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P., Rruga "...", ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1914/16, i datës 26.02.2020, në pikën e II- të të dispozitivit, ashtu që vendoset refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit R. K. nga P. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit që paditësin ta kthej në punë në pozitën e drejtorit të Departamentit Juridik apo në ndonjë vend tjetër të punës i cili i përgjigjet pozitës tjetër ekuivalente me pozitën që e ka mbajtur paditësi deri me datë 15.06.2016. V. Refuzohet ankesa e paditësit R. K. nga P. dhe pranohet pjesërisht ankesa e të paditurës Byroja Kosovare

Sigurimeve (BKS) me seli në P., Rruga dhe refuzohet ankesa e paditësit R. K. nga P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1914/16, i datës 26.02.2020, në pikën e III-të të dispozitivit dhe pika e I-rë e dispozitivit të Aktgjykimit Plotësues të datës 08.10.2020 ashtu që vendoset, aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. K. dhe Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve që paditësit në emër të diferencës së pagës për periudhën gusht 2016 deri me 30 qershor 2018 (periudha sa ka qenë në fuqi kontrata) t'ia paguajë shumën prej 13,667.18 euro, me kamatë prej 8% nga data e arritjes së secilës pagesë, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadiës përtej shumës së gjykuar e deri në shumën e kërkuar Refuzohet e pabazuar.

IV. Refuzohet ankesa e paditësit R. K. nga P. dhe pranohet pjesërisht ankesa e të paditurës Byroja Kosovare Sigurimeve (BKS) me seli në P., Rruga, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1914/16, i datës 26.02.2020, në pikën e V-të të dispozitivit ashtu që vendoset, aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. K. dhe Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve që paditësit në emër dhe llogari të paditësit pranë Administratës Tatimore të Kosovës t'ia deponojë shumën prej 799.25 euro dhe në emër dhe llogari pranë Trustit Pensional të Kosovës të deponojë shumën prej 1,518.58 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadiës në raport me këto kategori përtej shumës së gjykuar e deri në lartësinë e kërkuar Refuzohet e pa bazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditësit avokat Jeton Osmani nga P., në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore të LPK-së, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i paditëses, të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe që paditësit t'ia kompensoi shpenzimet e ankesës dhe të revizionit sipas tarifës avokatëve.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i të paditurës F. S. , në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore të LPK-së, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i paditëses, të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që të refuzohet ose hedhet kërkesëpadia e paditësit,

Pala paditëse ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditurës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar revizionin e të paditurës , ashtu që të aprovojë pretendimet e palës paditëse në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215 gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditësit është i pathemeltë

Revizioni i të autorizuarit të paditurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë së paditësi ka parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, më datë 25.08.2016, më konkretisht me arsye sikurse në padi. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, me aktgjykimin C.nr. 1914/16 i datës 26.02.2020, ka vendosur që të: Aprovohet kërkesëpadija e paditësit, si e themeltë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të këtij aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se vendimi i të paditurës me të cilat paditësi i është shqiptuar masa disiplinore, shkarkim nga pozita që e kishte deri në marrjen e vendimit të ankimuar, është marrë në mënyre të kundërligjshme, është i pa drejt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura me lartë, për arsye se masat disiplinore fillimisht shkarkimi nga pozita, ulja në pozitë e pastaj suspendimi i përkohshëm, në punë mund ti shqiptohet të punësuarit sipas procedurës në mënyrën dhe rrethanat e parashikuara me ligj, akte normative, të cilat janë të aplikueshme në Kosovë dhe kontratën kolektive që ishte fuqi në kohën e marrjes së vendimit të ankimuar, parashihet se procedurën disiplinore, e zhvillon komisioni disiplinor sipas kërkesës së organit kompetent, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës, për të cilat shkelje shqiptohet masat e ndërprerjes së marrëdhënies e punës apo ulje në pozitë, sipas procedurës se përcaktuar me ligj.

Ne rastin konkret, vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës respektivisht i uljes në pozitë, është marrë me shkeljen e procedurës se paraparë me dispozitat të cekura më lartë, për arsye së paditësi i ka realizuar te drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënies e punës, të e paditura dhe me asnjë prove të vetme nuk janë argumentuar shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënies se punës respektivisht shkarkimi nga pozita që e mbante paditësi, për të cilat pretendon e paditura, për arsye se procedura për konstatimin e përgjegjësisë se punëtorit për shkeljen e detyrave të punës, duhet të iniciohet dhe përfundoj procedura disiplinore në afatet e parapara ligjore dhe duke respektuar të gjitha të drejtat e punëtorit. Në këtë rast e paditura, nuk e ka respektuar afatin kohor për fillimin dhe përfundimin e inicimit të procedurës disiplinore, nuk e ka njoftuar me kohë për shkeljet e dyshuar dhe nuk ju ka dhënë mundësia e deklarimit me shkrim për shkeljen e dyshuar dhe nuk ju ka dhënë mundësia për tu këshilluar me këshilltarin juridik sipas zgjedhjes së tij apo për ti eliminuar shkeljet e pretenduar nga e paditura. Ngase siç u konstatua më lart paditësi në cilësinë e drejtorit kishte ndërmarr veprime duke dërguar email-a zyrtar, për parandalimin e shkeljeve të gjetura nga auditori i brendshëm, por i njëjti nuk ka gjetur përkrahje në shumicën e rasteve nga zyra brenda të paditurës

dhe nga drejtori Ekzekutiv, që rezulton se urdhrat e tij nuk janë përfillur në shume raste, nga e gjithë kjo rezulton se paditësi është shkarkuar nga pozita që mbante pa asnjë lloj procedure paraprake, inicim te procedurës disiplinore apo ndonjë vërejtje lidhur me detyrat e punës.

Gjykata e shkallës së parë, vlerëson se vendimet e ankimuara dhe të gjykuara si në pikën I, të aktgjykimit të goditur me ankesë, janë marr nga e paditura duke u bazuar në raportin e auditimit të brendshëm të datës 21.07.2016, i fokusuar pikërisht për Departamentin Juridik, ku paditësi ishte në pozitën e drejtorit, vendimet janë marr kinse si preventiv për eliminimin e shkeljeve të gjetura nga auditori i brendshëm. Mirëpo auditori i brendshëm ka konstatuar shkeljet si në raport, por në raport me paditësin, nuk ka gjetur asnjë shkelje dhe nuk ka iniciuar procedurë siç ka të drejtë auditori i brendshëm për te iniciuar procedurë, në kuptim të nenit 6 paragrafi Rregullores Nr. 05/2014, Mbi Procedurën e Përgjegjësisë Disiplinore, të paditurës. Përkundrazi auditori i brendshëm konstaton se paditësi ka kërkuar në vazhdimësi me email-a zyrtar, që të paraqitën më shumë oferta dhe lëndët të përfundojnë me ujdj jashtëgjyqësore, sidomos për lëndët e Gjykatës së Apelit, që të ekzekutohen vullnetarisht, e jo më përmbarrim të dhunshëm, të cilat ishin shkeljet e gjetura nga auditori, por jo në raport me paditësin sepse paditësit nuk ju kanë përfillur urdhrat e dhënë, në shumicën e rasteve nga zyra brenda të paditurës dhe në mungesë te përkrahjes nga Drejtori Ekzekutiv, i të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë, vendosi si në pikën -I- dhe -II-, të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, duke i anuluar vendimet e kontestuar dhe duke e detyruar të paditurën, që paditësi ta kthejnë në marrëdhënien e punës, në vendin e punës dhe detyrat punuese si në pozitën e ... i Departamentit Juridik dhe Administratës, apo në ndonjë vend tjetër të punës i cili i përgjigjet pozitës tjetër ekuivalente me pozitën që e ka mbajtur paditësi deri në ditën e shkarkimit nga pozita, për arsye se ndërprerja e marrëdhënies së punës respektivisht shkarkimi nga pozita, në bazë të vendimeve të kontestuara, ndaj paditësit nga ana e të paditurës, është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës dhe dispozitat e Rregullores Nr. 05/2014 Mbi Procedurën e Përgjegjësisë Disiplinore, të paditurës, të cekura me lartë. Gjykata e shkallës së parë, vendosi si në pikën -III-, të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, duke e detyruar të paditurën që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit për shkak të pamundësisimit të realizimit të ardhurave personale për diferencën e pagës, duke filluar nga data 01.08.2016 e deri me datë 31. 12.2019, ti paguaj për diferencën e pagës-neto, të pa paguara, në shumën prej 24,363.23 euro, me kamat ligjore 8%, duke filluar nga data 26.02.2020, dita kur është marr aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 5, 55 dhe 80, të Ligjit të Punës, e duke marrë për bazë ekspertizën financiare të datës 17.12.2019, e plotësuar në seancën e datës 12.02.2020, e punuar nga eksperti financiar E. P., të cilës gjykata ja fali besimin në tërësi për arsye se eksperti financiar ka bërë

llogaritjen e diferencës së pagës pa paguara të paditësit, në mënyrë të saktë për periudhën kohore sipas kërkesës së paditësit. Eksperti në mendimin e tij profesional në formë të shkruar dhe tabelore, ka sqaruar periudhën kohore për diferencën e pagës, bruto, kontributin pensional, tatimin në burim, pagën neto, e të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumen e tërësishme, duke marrë për bazë të gjitha provat në shkresat e lëndës.

Gjykata me rastin e marrjes së këtij aktgjykimi, ja ka njoh të drejtën paditësit në kompensimin e diferencës së pagave dhe bonuseve tjera, edhe përtej afatit të përcaktuar me kontratën e lartë cekur, respektivisht deri me datë 31.12.2019, dita kur është nxjerr ekspertiza financiare dhe të njëjtit gjykata ja aprovoi kërkesën edhe për kthim në pozitën e njëjtë të punës apo ekuivalente me pozitën e njëjtë, sikur e kishte paditësi para shkarkimit nga pozita. Sepse sikur gjykata të vendoste në kohë të arsyeshme, siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1, i Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj, apo të vendoste brenda periudhës kohore sa kishte validitet kontrata e paditësit, e theksuar më lartë, dhe siç janë me prioritet lëndët e kontesteve të punës në procedura gjyqësore, paditësi do të gëzonte të gjitha këto të drejta ashtu siç është gjykuar tani në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pasi që paditësi është shkarkuar nga pozita e tij e punës me vendime të kundërligjshme të marra nga e paditura, siç janë konstatuar më lart dhe të gjykuara, andaj asnjë palë në procedurë, e në këtë rast as paditësi nuk do të duhej të pësonte dhe të diskriminohet me vendime të kundërligjshme që të vendoset ndryshe vetëm për shkak të stërngarkimit më lëndë të gjykatave, për shkak të mos vendosjes në kohë të arsyeshme të këtij kontesti, brenda periudhës kohore sa kishte validitet të punës kontrata e paditësit me të paditurën, për këto arsye dhe arsyet tjera të dhëna si më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë, vendosi si në piken -III-, të dispozitivit të këtij aktgjykimit duke e detyruar të paditurën që paditësit në emër të kamatës ligjore 8%, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382, të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve me nr. 04/L-077, duke filluar nga data 26.02.2020, dita kur gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit nuk e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit dhe aktgjykimit plotësues, për arsye të aktgjykimi i atakuar edhe pse nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ndërsa e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar. Nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësit dhe të paditurës se aktgjykimi është marrë me vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Në rastin konkret edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga e cila ka rezultuar

se paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në mënyrë kundërligjore, respektivisht shkarkimi nga pozita e drejtorit të departamentit juridik, e madje vet e paditura ka nxjerrë disa vendime që nuk përputhen njëra me tjetrën që shihet qartë se gjithçka mundet me qenë përveç bazës juridike sepse nuk është se përputhen në mes vete, pra janë disi tendencioze për mënyrën se si janë nxjerr ato vendime e pastaj zëvendësuar. E paditura në procedura të brendshme nuk ka arritur ta vërtetojë përgjegjësinë e paditësit apo lëshimet e të njëjtit në raport me shkeljet që pretendojnë se janë bërë në departamentin që ai e ka udhëheq madje ka qenë ai që ka marr iniciativa për të ruajtur gjendjen financiare duke propozuar zgjidhje konkrete me qëllim evitimin e humbjeve financiare nga rastet në procedurë.

Pra sipas gjykatës së shkallës së dytë, ndaj paditësit është udhëheq një procedurë tërësisht e kundërligjshme sikurse edhe vendimet që janë marr në raport me të kanë qenë të kundërligjshme. Vendimet e të paditurës që janë marrë ndaj paditësit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe akteve të brendshme të paditurës si Rregullores nr.02/11 i datës 07.09.2011. Paditësit si udhëheqës i departamentit i janë atribuardështimet e personave tjerë brenda të paditurës që përkundër e-mail- eve të tij dhe urdhrave që nuk janë përfillur nga punonjësit e tjerë. Auditori i brendshme në të gjeturat e tij nuk ka gjetur ndonjë parregullsi apo shkelje nga ana e paditësit pasi që ka pasur mundësi vet auditori të iniciojë procedurë kundër paditësit gjë që nuk e ka bërë. Meqenëse procedura e udhëhequr nga e paditura ndaj paditësit është në tërësinë e saj e kundërligjshme sepse nuk ka procedurë të udhëhequr, pastaj nuk është vërtetuar gjendja faktike por ka qenë vendim arbitrar i të paditurës për mënyrës e veprimit, madje vendimet e mëvonshme të vet të paditurës në një mënyrë e ekspozojnë të paditurën dhe qëllimin për të dëmtuar paditësin. Në raport me kompensimet financiare gjykata drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike përmes ekspertizës financiare e cila ekspertizë edhe nga këndvështrimi i Gjykatës së Apelit i plotëson të gjitha elementet e një mendimi profesional, objektiv dhe të qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimet e palëve ndërgjyqëse për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë e gjeti se qëndron zbatimi i gabuar i të drejtës materiale por se ka qenë në favor të paditësit, për arsye Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e takuar sikurse në pikat e ndryshuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendimmarrjes si në aktgjykimin e datës 26.02.2020 e po ashtu edhe në aktgjykimin plotësuar gabimisht ka zbatuar të drejtë materiale andaj Gjykata e Apelit vendosi që të ndryshoj aktgjykimin dhe të gjykojë vetë çështjen si në pikat e dispozitivit të këtij aktgjykimi. Për këto arsye e ka ndryshuar aktgjykimin si në dispozitiv.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e te dya palëve për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së dytë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara. Aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsyet për ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, po ashtu ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm. Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

Për Gjykatës Supreme të Kosovës është i pa pranueshëm pretendimi i paditësit dhe të paditurës për strukturën e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në kuptim të nenit 160.5 të LPK-së i cili parasheh se " Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor. " Gjykata Supreme aprovon vlerësimin e gjykatës së shkallës së dytë, kur ka vlerësuar se për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, përkatësisht drejtë janë zbatuar dispozitat nga neni 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës i cili parasheh se " Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së

arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës. "

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovoi qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët se auditori i brendshëm ka konstatuar shkeljet si në raport, por në raport me paditësin, nuk ka gjetur asnjë shkelje dhe nuk ka iniciuar procedurë siç ka të drejtë auditori i brendshëm për të iniciuar procedurë, në kuptim të nenit 6 paragrafi Rregullores Nr. 05/2014, mbi Procedurën e Përgjegjësisë Disiplinore, të paditurës, dhe procedura e e ndjekur nga e paditura ishte e kundërligjshme. Pretendimi i të paditurës se me rastin e suspendimit ose shkarkimit nga pozita e drejtorit nuk i është ndërprerë kontrata por kjo pozitë i nënshtrohet procedurave të emërimit nuk qëndron për faktin se sipas gjykatës së shkallës së dytë, e me këtë pajtohet edhe gjykata e revizionit, ndaj paditësit është udhëheq një procedurë tërësisht e kundërligjshme sikurse edhe vendimet që janë marr në raport me të kanë qenë të kundërligjshme. Në arsyetimin e dhënë i atribuohen shkeljet dhe veprimet e të tjerëve për të cilat nuk është provuar se janë ta paditësit

Ndërsa sa i përket pjesës ë ndryshuar të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket refuzimit të kompensimit të ardhurave për tej periudhës së përfshirë në kontratë dhe kthimit në vendin e punës në pozitën që ka qenë para vendimit të paditurës, Gjykata Supreme e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë sepse me të drejtë është konstatuar se paditësi te e paditura pozitën e të departamentit juridike ka pasur me kontratë me kohë të caktuar dhe se para përfundimit të kësaj kontrate i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas pozitës apo është liruar nga ajo pozitë, ndërsa gjykata e shkallës së parë e ka obliguar të paditurën që paditësin ta kthej në vendin e njëjtë apo në tjetër vend që i përgjigjet pozitës ekuivalente, në këtë rast vendimmarrja e gjykatës është jo në përputhje me ligjin. Në pozitat e emëruara apo me kohë të caktuar por edhe në pozita drejtuese pas skadimit të kontratës nuk ka asnjë mundësi që personi të kthehet në vendin e njëjtë e as vend tjetër ekuivalent sepse kjo përbën cenim të funksionimit të brendshme të paditurës pasi gjykata nuk ka tagër vendos në vend të organeve të caktuara të paditurës që janë të autorizuar të zgjedhin drejtuesit. Kompensimi mbi bazën ndërprerjes së kontratës në mënyrë të pa ligjshme është edhe në përputhje me Ligjin e Punës më konkretisht neni 80.1.

Rrjedhimisht edhe sipas Gjykatës Supreme e të Kosovës, gabimisht është caktuar kompensimi monetar për paditësin kur është vendosur që ta obligojë të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 24,363.23 €, pra nga data 01.08.2016 e deri me 31.12.2019, deri me rastin e hartimit të ekspertizës financiare, prandaj detyrimi i kompensimit jashtë validitetit të kontratës është në kundërshtim të plotë me Ligjin e Punës ashtu sikur se detyrimi për kthim në vendin e njëjtë

në pozitë mandatorë me afat dhe kompensimi jashtë periudhës së kontratës. Rrjedhimisht e dhe vendimi i gjykatës së shkallës së dytë për ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë edhe në raport me detyrimet për pagesë të paditurës në emër të paditësit pranë Administratës Tatimore të Kosovës dhe Trustit Pensional të Kosovës, pasi këto janë të ndërlidhura me lartësinë e pagës, pra ndajnë fatin e vendimmarrës në raport me pagën si kërkesë. Edhe ndryshimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë në raport me rrjedhjen e kamatës, është në përputhe me praktikën gjyqësore dhe Mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës. pasi kamata tek pagat si kërkesa monetare apo dëme material fillon të rrjedh veç e veç nga secila kërkesë e arritur pra dhe jo në tërësinë e tyre.

Lidhur me pretendimet e revizionit të paditurës se në raste të ngjashme, kolegjet e Gjykatës Supreme kanë vendosur ndryshe, Gjykata Supreme e pati në konsideratë dhe shqyrtoi rastet e mbi të cilat pala e paditur në revizion potencon faktin se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit, me çka për mes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme për situata të njëjta. Në rastet e potencuar nuk kishte ngjashmëri me rastin konkret, prandaj edhe ky pretendim u refuzua si i pa bazuar.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale dhe se e paditura nuk mund të detyrohet në kompensimin e diferencës së pagës të kërkuar nga pala paditëse, kjo pasi që palët ndërgjyqëse raportin mes tyre e kanë rregulluar me kontratë të punës ku me pikë të veçantë të kontratës është caktuar paga dhe kohëzgjatja. Prandaj, mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë drejtë e gjykatat e shkallës së dytë ka zbatuar të drejtën materiale, dhe Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon në tërësi këtë qëndrim.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet tjera të revizionit por nuk u gjeten si relevante për vendimmarrje meritore tjetër. Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga i autorizuari paditësit dhe të paditurës nuk janë vlerësuar, pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga sa u tha më sipër Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat është paraqitur revizionet e te dy palëve dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.504/2024, datë 18.11.2024

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami